



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Prilijeno: 22.05. 2023		
Njësia Jednica:	Numri Broj:	Shtojca Dodatak:
1-345/02-26182		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT

Datë:	22.05.2023
Referencë:	
Për:	Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi –Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
Kopje:	Diamant Bytyqi– Nënkyetar i Komunës Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës
Nga:	Komisioni për hartimin e Rregullores në bashkëpunim me Zyrtarin përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të standarteve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit.
Lënda:	Raport: Propozim Rregulloren për Transportin e Udhëtarëve me Automjete taksi

Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2020 për transparencë në Komuna, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739 e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikbërjes dhe vendimarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, në bashkëpunim me sektorin për marrëdhënie me publikun kanë shpallur në:

KONSULTIM PUBLIK

Propozim Rregulloren për Transportin e Udhëtarëve me Automjete Taksi

Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i konsultimeve publike ku ka qenë në diskutim publik Propozim Rregulloreja si edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet.

Shih linqet:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/konsultimet-publike/dokumentet-ne-konsultim-publik/>

Ecuria e Procesit

Komisioni për hartimin e Rregullores në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitatat e Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna dhe në bashkëpunim me kordinatorin për konsultime publike ka publikur në web faqen e komunës Njoftimi për Diskutim Publik të Propozim Rregullores për Transportin e Udhëtarëve me Automjete Taksi

në linkun: <https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2023/04/njoftimi-per-debat-publik-shqip.pdf>

Po ashtu kjo projekt rregullore është publikuar edhe në platformen e qeverise për konsultime publike në dy gjuhët zyrtare, po ashtu në këtë platformë është publikuar Njoftimi për Diskutim Publik të Propozim Rregullores për Transportin e Udhëtarëve me Automjete Taksi.

Linku: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41817>

<https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Meetings/14-53-31-25042023/njoftimi-per-debat-publik-shqip.pdf>

Njoftimi për diskutim publik është shpall në afatin e paraparë ligjor, duke u bazuar në nenin 16 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, po ashtu palët e interesuara janë njoftuar me datën, vendin, kohën për mbajtjen e takimit publik. Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i shqyrtimeve publike ku ka qenë në diskutim publik Propozim Rregulloren për Transportin e Udhëtarëve me Automjete Taksi si edhe informatat shtesë se kujt i adresohen komentet. Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetet sociale të komunës.

Ndërsa takimi konsultativ-debati është realizuar në kohën e paraparë dhe me dt. **05.05.2022** është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit duke filluar nga orëa 10:00.

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/news/diskutohet-projekt-rregullorja-per-transportin-e-udhetareve-me-automjete-taksi/>

Konsultimi publik realizuar në kohën e paraparë dhe filloi në orën 10:00

Nën kryesimin e Burim Rustemit - kryesues i komisionit për hartimin e kësaj rregullore u hap takimi me ç ‘rast ai ka përshëndetur të gjithë të pranishmit duke i falënderuar për pjesëmarrje si dhe prezantoi anëtarët e komisionit të cilët hartuan draft rregulloren në fjalë:

1. Burim Rustemit – Drejtor i DSHP dhe kryesues i komisionit për hartimin e rregullores
2. Vlora Krasniqi – Shefe e sektorit për përfaqësim dhe çështje ligjore,
3. Rafete Retkoceri – Zyrtares Ligjore, Drejtorati për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim,
4. Bujar Curri – Inspektor i Komunikacionit, Drejtorati për Inspektorat,
5. Behar Mjeku - Inspektor i Komunikacionit, Drejtorati për Inspektorat,

Draft rregullorja u prezantua nga Drejtori i Drejtoratit për Shërbime Publike Burim Rustemi, njëherit edhe Kryesues i Komisionit për hartimin e kësaj rregullore i cili ka theksuar se aktualisht kjo rregullore është në fazën e konsultimeve me publikun dhe planifikohet të dërgohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e Kuvendit Komunal e cila mbahet në fund të këtij muaji. Ai po ashtu para të pranishmëve dhe me qëllim që t’i ofroj publikut qasje të lehtë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës si dhe rritjen e mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimarrëse, ka prezantuar draft Rregulloren për Transportin e Udhëtarëve me Automjete Taksi.

Kryesuesi z.Rrustemi, para të pranishmëve ka thënë se Komuna e Lipjanit ka përfillur të gjitha procedurat për të konsultuar me publikun këtë rregullore e cila pritët të miratohet në seancën e Kuvendit të Komunës të muajit maj dhe kërkoi nga të pranishmit që të japin vërejtjet dhe komentet e tyre rreth këtij drafti pasi ata e kanë mundësinë që të japin propozime konkrete rreth dispozitave të kësaj Projekt Rregulloreje.

Diskutimi u bë në mënyrë të hapur dhe u diskutuan shumë çështje, duke përfshirë: kriteret dhe kushtet për marrjen e Licencës nga operatorët auto taksi, proceduen e lëshimit, revokimit dhe marrjes së licencës, caktimi i vendparkingjeve, ndalesat gjatë ushtrimit të veprimtarisë si dhe masat për mosrrespektimin e rregullores.



Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuesve
1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	30 ditë pranohen	16
2. Publikimi në ueb faqe	30 ditë	

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë 16 pjesëmarrës, prej tyre **8** femra dhe **8** meshkuj.

Gjatë këtij debati ka pasur edhe angazhime nga të pranishmit ku është diskutuar për çështjet të ndryshme dhe kanë kërkuar sqarime rreth këtij dokumenti.

Temat e Konsultimit	Komentet	Kush ka komentuar	Përgjigje në pyetjet / komentet e parashtruara	Komente (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin te komenteve është i detyrueshëm)
Raport: Propozim Rregulloren për Transportin e Udhëtarëve me Automjete taksi	– qytetare e Komunës së Lipjanit propozoi që për automjetet të cilët ushtrojnë veprimtarinë auto taksi vjetërsia e automjeteve të jetë jo më e vjetër se 15 vjet.	Mimoza Drevija	Burim Rustemi – Sqaroi se lidhur me këtë çështje komisioni e ka propozuar që operatorët auto taksi të cilët operojnë në qytetin e Lipjanit të kenë automjetin me vitin e prodhimit jo më të vjetër se viti 2005 ndërsa operatorët të cilët operojnë në Aeroportin ndërkombëtarë “Adem Jashari” të kenë automjetin me vitin e prodhimit jo më të vjetër se viti 2010	Komenti u pranua
Raport: Propozim Rregulloren për Transportin e Udhëtarëve me Automjete taksi	propozoi që ngjyra e automjeteve taksi të jetë ngjyrë unike për të gjithë operatorët në	Kumrije Reçica	Burim Rustemi - sqaroi se në propozim rregullore është përcaktuar se ngjyra mund të	Komenti u pranua pjesërisht

	mënyrë që të identifikohen më lehtë nga qytetarët si taksi.		të jetë e ndryshme por me kusht që automjetit ti vendoset një shirit identifikues me ngjyrë bardhë e zi në formë katrore, ndërsa automjetet që operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” të jenë të ngjyrosura vetëm me ngjyrën e bardhë. Po ashtu automjetet që operojnë taski në Komunën e Lipjanit të kenë të vendosur mbi kabinë paralel me erëmbrojtësin tabelën me dimensione standarde e paisur për ndriqim edhe natën me shenjën “TAXI”.	
Raport: Propozim Rregulloren për Transportin e Udhëtarëve me Automjete taksi	propozoi që çmimorja e shërbimeve dhe çmimi të mos jetë shumë i lartë sepse qytetarët nuk kanë mundësi të pagesës së çmimeve të larta të transportit të udhëtarëve.	Valdete Muji	Burim Rrustemi - ka sqaruar se çmimi dhe çmimorja e shërbimeve përcaktohen nga vetë operatorët pasi që ashtu edhe është përcaktuar edhe	Komenti nuk u pranua

			me Ligjin për Transpotin Rrugor dhe po ashtu edhe në nenin 14 të kësaj Propozim Rregulloreje është përcaktuar se operatorët duhet të përcaktojnë çmimoren e shërbimeve.	
--	--	--	---	--

Shtojcë: Lista e pjesëmarrësve

Bukurie Zejnullahu-Jashari

Zyrtare përgjegjëse për kordinimin e konsultimeve publike



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lista e pjesëmarrësve në debatin e hapur publik i mbajtur me datë 05.05.2023 për Propozim Rregulloren për Transportin e Udhëtarëve me Automjete Taksi:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi
1.	Burina Rustemi	
2.	Raphe Bekocari Jakullahu	
3.	Arumi Sahib	
4.	VALDETE RLUJI	
5.	Bukure Zyhylli	
6.	Qëndresa Jashumina	
7.	VLORA KRAJNIAI	
8.	XHELIL MURATI	
9.	BAKI ZEWEXI	
10.	Adnan Allani	
11.	LABINOT DEDUSHI	
12.	Salih Mavri	
13.	Mimoza Drevija	
14.	Miradije Gëstani	
15.	BUDAR CUSRI	
16.	BEHAR MJEKU	
17.		
18.		
19.		
20.		
21.		
22.		
23.		
24.		
25.		
26.		
27.		
28.		
29.		
30.		
31.		

32.		
33.		
34.		
35.		
36.		
37.		
38.		
39.		
40.		
41.		
42.		
43.		
44.		
45.		
46.		
47.		
48.		
49.		
50.		
51.		
52.		
53.		
54.		
55.		
56.		
57.		
58.		
59.		
60.		
61.		
62.		
63.		
64.		
65.		
66.		
67.		
68.		
69.		
70.		
71.		
72.		
73.		
74.		
75.		
76.		